




MBYLLËN NJË PLATFORMË, JO NJË **PROBLEM**

RAPORT MONITORIMI

Korrik 2025



AUTOR
Ritvana Hajdari

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
1. PAKETA E MASAVE TË PROPOZUARA NGA MINISTRIA	4
2. STATISTIKA MBI VETËVRASJET DHE DHUNËN	6
2.1 Analiza e vetëvrasjeve ndër vite (2023-2025)	6
2.2 Analiza e tentativave për vetëvrasje ndër vite (2023-2025)	7
2.2.1 Përfundim i analizës së vetëvrasjeve dhe tentativave për vetëvrasje (2023–2025)	9
2.3 Analiza për vrasje ndër vite (2023-2025)	9
2.4 Analiza e rasteve të dhunës me dashje ndër vite (2023- 2025)	11
2.5 Faktorët nxitës	12
3. ROLI I TIKTOK NË NXITJEN OSE PARANDALIMIN E DHUNËS	14
3.1 Gjetjet nga pyetësi: Ndikimi i rrjeteve sociale dhe mbyllja e TikTok-ut	14
3.2 A ndikoi mbyllja e TikTok në uljen e dhunës dhe përmirësimin e shëndetit mendor?	24
GJETJET KRYESORE	26
REKOMANDIME	27



HYRJE

TikTok është kthyer në një hapësirë të rëndësishme për vetë-shprehje, argëtim dhe ndërveprim tek të rinjtë. Në Shqipëri, rritja e përdorimit të platformës është shoqëruar edhe me përhapjen e përmbajtjeve të papërshtatshme, ku sipas raprit¹ “One click Away” nga UNICEF ALBANIA 14% e fëmijëve kanë përjetuar eksperiencë shqetësuese në internet. Megjithatë, aktorë të shoqërisë civile dhe ekspertë të fushës së të drejtave të fëmijëve e kanë konsideruar mbylljen si një masë të pjesshme dhe jo të mbështetur në një strategji gjithëpërfshirëse të mbrojtjes dhe edukimit mediatic. Mungesa e masave paralele si ofrimi i mbështetjes psikologjike për të rinjtë, fuqizimi i shkollave me programe të edukimit për sigurinë digjitale dhe përfshirja sistematike e institucioneve në terren mbeten boshllëqe që vendimi nuk i adreson. Kjo e bën të nevojshme një analizë të detajuar për të kuptuar jo vetëm efektet e mbylljes në nivel formal, por edhe ndikimet e tij në ndjenjat, sjelljet dhe sigurinë emocionale të të rinjve shqiptarë.

Ky raport ka për qëllim të shqyrtojë duke u bazuar në të dhëna nëse mbyllja e TikTok në Shqipëri ka ndikuar realisht në uljen e rasteve të dhunës, sidomos në mesin e të rinjve. Vendimi për të bllokuar përkohësisht këtë platformë erdhi pas një ngjarje tragjike në Nëntor 2024, ku një 14-vjeçar u vra pas një konflikti që kishte nisur në rrjetin social Snapchat. Ngjarja ngjalli reagim të gjerë publik dhe qeveria njoftoi se TikTok do të mbyllej për një vit për arsye të sigurisë së të miturve.² Mbyllja zyrtare nisi më 13 mars 2025 dhe u mbështet nga Kryeministri Rama si një masë për “mbrojtjen e fëmijëve nga përmbajtjet e dhunshme” të cilat, sipas autoriteteve, nxisin sjellje të papërshtatshme tek të rinjtë (Këshilli i Ministrave, 2025). Ky raport vë në qendër pyetjen: a është një masë e tillë e mjaftueshme për të reduktuar dhunën, apo vetëm një ndërhyrje simbolike pa ndikim real në ndryshimin e sjelljes?

Për të vlerësuar me saktësi ndikimin e kësaj mase në shoqëri, raporti mbështetet në një qasje të kombinuar metodologjike. Së pari, është zhvilluar një analizë e dokumenteve, duke shqyrtuar të dhënat e raportuara nga Policia e Shtetit si dhe organizata të shoqërisë civile

¹ UNICEF Albania. (2020). One Click Away: Children's experience of Internet use in Albania.

Link: https://www.unicef.org/albania/sq/media/2581/file/NJe_klikim_larg_2020.pdf

² Këshilli i Ministrave. (2025). Vendimi nr. 151, datë 6.3.2025, për marrjen e masave të përkohshme për shmangien e ndikimeve negative të platformës online “TikTok”. Fletorja Zyrtare, nr. 47, datë 07.03.2025. Marrë nga Qendra e Botimeve Zyrtare: <https://www.qbz.gov.al/eli/fz/2025/47/cb100028-6949-4fd0-9fdd-89150451ae80>



që merren me çështjet e të rinjve dhe dhunës. Së dyti, janë përfshirë të dhëna nga media dhe raportime publike që pasqyrojnë tendencat e dhunës gjatë dhe pas mbylljes së platformës. Së fundi, është përfshirë një pyetësor mbi përdorimin e rrjeteve sociale, i cili synon të masë perceptimin e të rinjve lidhur me mbylljen e TikTok dhe ndikimin e tij në përditshmërinë e tyre emocionale, sociale dhe të sjelljes. Pyetësori është shpërndarë në një kampion të përzgjedhur të të rinjve të moshës 15–24 vjeç, në zona urbane dhe rurale, për të siguruar një panoramë të balancuar të situatës. Kjo metodologji lejon që analizat e mëposhtme të mos mbështeten vetëm në numra, por të reflektojnë edhe përjetimet subjektive dhe dimensionin psikosocial të mbylljes. Ky raport e sheh mbylljen jo vetëm si një masë me efekt të kufizuar në nivelin e dhunës, por si një moment që ngre pyetje të rëndësishme për mënyrën si politika publike ndërhyjnë në aspektin psikologjik të të rinjve, dhe sa përputhen këto ndërhyrje me realitetin që ata përjetojnë çdo ditë.

1. PAKETA E MASAVE TË PROPOZUARA NGA MINISTRIA

Në përballje me problematikat në rritje të dhunës në shkolla, përfshirë bullizmin, vetëdëmtimin dhe sjelljet antisociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë një seri masash të cilat përbëjnë thelbin e asaj që njihet si “Paketa e Sigurisë në Shkolla”.³ Një nga komponentët kryesorë të kësaj nisme është rritja e numrit të oficerëve të sigurisë në institucionet e arsimit parauniversitar. Sipas një deklarate të ndërmarrë këtë vit, janë certifikuar 77 oficerë të rinj të sigurisë, duke synuar që numri total të arrijë në 400 oficerë në mbarë vendin, nga 270 që ishin më parë. Për herë të parë, është përfshirë edhe arsimi profesional në këtë proces, ndërsa është rishikuar raporti mes numrit të nxënësve dhe oficerëve duke përcaktuar nga një oficer për shkollat me mbi 350 nxënës, deri në dy oficerë për shkolla me mbi 900 nxënës. Masat e reja përfshijnë gjithashtu elementë të teknologjisë digjitale, si vendosja e kamerave në mjediset shkollore në kuadër të projektit “Smart City”, si dhe përdorimi i platformës SMIP, që synojnë përmirësimin e ndërveprimit mes mësuesve, prindërve, psikologëve dhe oficerëve të sigurisë. Këto mekanizma teknologjikë ofrojnë informacion në kohë reale mbi ecurinë, prirjet apo sjelljet problematike të nxënësve, duke synuar parandalimin në kohë të fenomeneve të rrezikshme. Përmes SMIP dhe fletoreve të komunikimit digjital, prindërit marrin informacion në



³ <https://arsimiparauniversitar.gov.al/certifikohen-77-oficere-te-rinj-sigurie-manastirliu-rrisim-ne-400-numrin-e-oficereve-te-sigurise-ne-shkolla-per-here-te-pare-edhe-ne-arsimin-profesional/>

kohë reale për sjelljet e fëmijëve, talentet dhe prirjet e tyre, por edhe për fenomenet që ata kanë nevojë të njihen menjëherë si mënyra se si fëmijët komunikojnë me njëri-tjetrin apo shqetësime që mund të lindin gjatë orarit mësimor apo jashtë tij. Ky sistem i zgjeruar komunikimi mundëson që jo vetëm mësuesi kujdestar apo mësuesi i lëndës, por edhe oficeri i sigurisë, punonjësi social dhe psikologu i shkollës të jenë aktivë në shkëmbimin e informacionit me prindërit, duke forcuar kështu qasjen ndërinstitucionale për sigurinë dhe mirëqenien e nxënësve. Këto masa digjitale kanë qënë të parashikuara në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të miratuar që në vitin 2021, gjë e cila dëshmon që nuk kemi të bëjmë me platforma të reja për paketën e sigurisë në shkollë. Por realisht a ka sot një paketë për sigurinë në shkollë?

Qëndresa Qytetare i ka dërguar një kërkesë zyrtare për informacion pranë Ministrisë së Arsimit mbi masat që janë ndërmarrë në kuadër të paketës së sigurisë në shkollë dhe shpërndarjen aktuale të oficerëve të sigurisë, por Ministria e Arsimit nuk ka kthyer përgjigje duke anashkaluar çdo afat ligjor. Kjo qasje e Ministrisë bëhet faktor pengues për ndërtimin e një analize të plotë dhe objektive mbi ndikimin konkret të masave të ndërmarra. Megjithatë, të dhënat empirike të dokumentuara në këtë raport përfshirë mbi 230 tentativa për vetëvrasje në një periudhë vetëm 28 mujore (Janar 2023–Prill 2025), si dhe rritjen e rasteve të dhunës me dashje sugjerojnë qartë se efektiviteti i ndërhyrjeve institucionale ka qënë i kufizuar. Në mungesë të një strategjie të koordinuar dhe të monitorimit sistematik, masat aktuale rezultojnë të pamjaftueshme për të përballuar sfidat komplekse që lidhen me sigurinë, mirëqenien psikologjike dhe parandalimin e fenomeneve të rënda sociale në mjediset shkollore dhe përtej tyre. Një vlerësim kritik i politikës së ndërmarrë tregon se qasja aktuale është e orientuar më shumë drejt aspektit fizik të sigurisë sesa drejt ndërtimit të një mjedisi mbështetës emocional për nxënësit. Prania e oficerëve të sigurisë është thelbësore, por ajo nuk mund të zëvendësojë rolin e psikologut dhe mbështetjes psikosociale në shkollë. Në shumë institucione, psikologët janë ose të paktë ose mungojnë, ndërsa raporti aktual psikolog–nxënës është në nivele shumë më të larta sesa rekomandimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë ku sipas së cilës raporti duhet të jetë 1:500.



2. STATISTIKA MBI VETËVRASJET DHE DHUNËN

2.1 Analiza e vetëvrasjeve ndër vite (2023-2025)

Të dhënat zyrtare të Policisë së Shtetit për periudhën 2023–2025 tregojnë një rritje progresive të numrit të vetëvrasjeve në Shqipëri. Në vitin 2023 u regjistruan gjithësej 98 raste vetëvrasje. Kjo një shifër që mund të konsiderohet e lartë, për një vend me strukturën demografike të Shqipërisë, ngre shqetësime serioze në lidhje me shëndetin mendor të popullsisë, veçanërisht duke pasur parasysh përhapjen e çrregullimeve emocionale në periudhën post-pandemike. Në vitin 2024, vetëvrasjet u rritën në 112 raste, duke shënuar një rritje me 14 raste në krahasim me vitin pararendës. Ky ndryshim përfaqëson një rritje afërsisht 14.3%, që në terma të statistikës publike është domethënëse dhe nuk mund të konsiderohet si një luhatje normale vjetore. Përkundrazi, rritja konstante e rasteve tregon një prirje të përkeqësimit të situatës së shëndetit mendor në vend dhe sugjeron një mungesë të ndërhyrjes efektive për parandalimin dhe trajtimin e krizave personale dhe sociale. Një element që e bën edhe më shqetësuese këtë situatë është fakti se, pavarësisht rritjes së vëllimit të përgjithshëm të vetëvrasjeve, nuk ka prova që të kenë ndryshuar ndjeshëm kapacitetet institucionale për përballimin e saj. Situata për vitin 2025 është veçanërisht alarmante. Sipas të dhënave të siguruara, për periudhën Janar–Prill janë regjistruar 45 vetëvrasje. Edhe pse bëhet fjalë vetëm për katër muaj të parë të vitit, kjo shifër është shumë më e lartë në krahasim me dy vitet paraardhëse. Nëse kjo tendencë mbetet konstante, numri i vetëvrasjeve deri në fund të vitit 2025 mund të projektohet të arrijë në rreth 135 raste, duke përfaqësuar kështu një rritje me mbi 20% krahasuar me vitin 2024 dhe me më shumë se 37% krahasuar me vitin 2023. Ky projektion evidenton qartë se rritja e rasteve nuk është e përkohshme, por mund të jetë pjesë e një trendi të vazhdueshëm në mungesë të ndërhyrjeve strukturore. Në terma të analizës krahasuese, trevjeçari 2023–2025 tregon një përshpejtim të ritmit të vetëvrasjeve në vend. Ndërkohë që ndryshimi midis 2023 dhe 2024 ishte i dukshëm, por ende brenda një kufiri të kontrollueshëm, ndërsa të dhënat për vitin 2025 sinjalizojnë një përkeqësim të mundshëm shumë më të shpejtë. Rritja e shpejtë dhe e vazhdueshme e rasteve sugjeron jo vetëm përkeqësim të kushteve individuale të jetesës apo shëndetit emocional të qytetarëve, por edhe dështim të mekanizmave të identifikimit, ndërhyrjes dhe mbështetjes institucionale ndaj individëve në rrezik. Kjo analizë e të



dhënave nuk mund të identifikojë me saktësi arsyet e kësaj rritje, por ajo përbën bazën e domosdoshme për të ndërtuar më tej diskutimin mbi faktorët ndikues, si dhe për të ngritur kërkesën për politika më të forta publike në mbrojtje të shëndetit mendor. Ecuria e vetëvrasjeve në këto tre vite kërkon vëmendje të menjëhershme nga institucionet, si dhe angazhimin e aktorëve socialë dhe komunitarë për të kuptuar rrënjët e këtij fenomeni dhe për të ndërtuar një sistem gjithëpërfshirës mbështetje për individët në rrezik.

Tabela.1 Vetëvrasjet në Shqipëri, krahasim ndërvite 2023, 2024 dhe projeksion për 2025

Viti	Numri total i vetëvrasjeve	Ndryshimi në përqindje
2023	98	-
2024	112	+14.3%
2025	45 (Janar–Prill) Projeksion $\approx$ 135	+20.5% krahasuar me 2024

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. (2025, 13 qershor). Të dhëna statistikore për vrasjet, vetëvrasjet dhe rastet e dhunës për të rinjtë 2023–2025. ⁴

2.2 Analiza e tentativave për vetëvrasje ndër vite (2023-2025)

Përveç rasteve të vetëvrasjeve të përfunduara, një tregues po aq i rëndësishëm për të vlerësuar gjendjen e shëndetit mendor në vend janë edhe rastet e tentativave për vetëvrasje. Këto raste shpesh përfaqësojnë sinjale të drejtpërdrejta të krizave emocionale të individëve, të cilat nëse kapen dhe trajtohen në kohë, mund të parandalojnë fatalitetet. Në vitin 2023, numri total i tentativave për vetëvrasje të raportuara ishte 79. Në vitin 2024, sipas të dhënave të ofruara nga Policia e Shtetit, numri i tentativave për vetëvrasje mbeti i njëjtë (sërish 79 raste të raportuara). Ky stabilitet i shifrave në pamje të parë mund të krijojë përshtypjen se situata është e qëndrueshme. Megjithatë, një analizë më e detajuar e kësaj të dhëne, në kontekstin e rritjes së vetëvrasjeve të përfunduara për të njëjtin vit, ngre dyshime serioze në lidhje me efektivitetin e identifikimit dhe trajtimit të individëve në rrezik. Nëse rastet e tentativave nuk janë rritur, por numri i vetëvrasjeve ka pësuar rritje, kjo mund të nënkuptojë se shumë individë në krizë nuk kanë pasur asnjë ndërhyrje parandaluese ose nuk janë evidentuar në kohë. Pra, ekziston mundësia që ndërhyrja institucionale të mos ketë ndodhur

⁴Shënim: Për vitin 2025, të dhënat i përkasin vetëm periudhës Janar–Prill. prandaj për qëllime krahasimi, është bërë një projeksion proporcional vjetor duke shumëzuar shifrat me 3, për të përfaqësuar ritmin e mundshëm për gjithë vitin ku rezultojnë në total 135 raste të projektuara.



në një fazë ku jeta e tyre mund të shpëtohej. Në katërmujorin e parë të vitit 2025 (Janar–Prill), janë raportuar 28 tentativa për vetëvrasje. Edhe pse bëhet fjalë vetëm për katër muaj, nëse ky ritëm vazhdon, projeksioni për të gjithë vitin është rreth 84 raste një rritje krahasuar me vitin 2024. Kjo prirje paraqet një element të rëndësishëm për strukturat përgjegjëse, sepse tregon se gjithnjë e më shumë individë po përjetojnë kriza emocionale të cilat, edhe pse nuk përfundojnë me fatalitet, kanë arritur në atë pikë ku kërkojnë ndërhyrje emergjente. Rritja e lehtë e tentativave në vitin 2025, së bashku me rritjen shumë më të lartë të vetëvrasjeve të përfunduara, përforcon bindjen se shëndeti mendor është në krizë. Ndryshe nga rastet fatale, tentativa për vetëvrasje përfaqëson një dritare mundësie për institucionet dhe profesionistët e shëndetit mendor. Çdo rast i tillë përbën një thirrje për ndihmë dhe mund të konsiderohet si një rast potencial për ndërhyrje të suksesshme, përmes trajtimit psiko-social, terapisë ose mbështetjes komunitare. Në këtë kuadër, është e domosdoshme të theksohet se mungesa e ndryshimit në numrin e tentativave gjatë vitit 2024, krahasuar me vitin 2023, nuk duhet të interpretohet si tregues pozitiv i stabilitetit, por më tepër si një reflektim i mungesës së sistemit të raportimit dhe ndihmës. Po ashtu, të dhënat për tentativat në këto tre vite nxjerrin në pah nevojën për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të mbikëqyrjes dhe menaxhimit të riskut për vetëdëmtim. Mungesa e detajimit të të dhënave sipas moshës, vendbanimit apo faktorëve socialë, bëhet faktor pengues për analizën e plotë të situatës dhe e bën të vështirë ndërtimin e politikave të targetuara. Sidoqoftë, prania e më shumë se 230 tentativave për vetëvrasje në vetëm 28 muaj (Janar 2023–Prill 2025) është një tregues i pamohueshëm i rëndësës që ka kriza të shëndetit mendor në vend dhe të urgjencës për të ndërhyrë në mënyrë gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe trajtimin e tyre.

Tabela.2 Tentativa për vetëvrasjet në Shqipëri, krahasim ndër vite 2023, 2024 dhe projeksion për 2025

Viti	Tentativa të raportuara	Diferenca vjetore
2023	79	-
2024	79	0
2025	28 (Janar–Prill) Projeksion 84	Projeksion +6.3%



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. (2025, 13 qershor). Të dhëna statistikore për vrasjet, vetëvrasjet dhe rastet e dhunës për të rinjtë 2023–2025.

2.2.1 Përfundim i analizës së vetëvrasjeve dhe tentativave për vetëvrasje (2023–2025)

Të dhënat e Policisë së Shtetit për periudhën 2023–2025 tregojnë një përshkallëzim të dukshëm të fenomenit të vetëvrasjeve në Shqipëri. Rritja progresive nga 98 raste në vitin 2023, në 112 në vitin 2024 dhe një projeksion prej rreth 135 rastesh në vitin 2025 pasqyron një krizë në zhvillim të mirëqënies emocionale të popullsisë, e cila po thellohet vit pas viti. Ndërkohë, tentativat për vetëvrasje janë shifra të qëndrueshme në 2023 dhe 2024, me nga 79 raste për secilin vit, por kanë shënuar një rritje të lehtë të projektuar për vitin 2025, me rreth 84 tentativa. Kjo rritje e vetëvrasjeve të përfunduara dhe një rritje modeste e tentativave ngre shqetësime serioze për mungesën e ndërhyrjes së hershme dhe mbështetjes psikosociale. Në tërësi, të dhënat konfirmojnë se vetëdëmtimi dhe krizat emocionale janë në rritje, ndërsa kapacitetet institucionale për t'i trajtuar në mënyrë efektive mbeten të kufizuara dhe jopërmbushëse për përmasat e problemit. Ky konstatim përforcon nevojën për ndërhyrje të menjëhershme në fushën e shëndetit mendor dhe ngritjen e mekanizmave efikasë të parandalimit.

2.3 Analiza për vrasje ndër vite (2023-2025)

Vrasjet përfaqësojnë formën më ekstreme të dhunës në një shoqëri dhe shërbejnë si tregues i ndjeshëm për gjendjen e sigurisë publike, klimës sociale dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë penale. Të dhënat për vrasjet në Shqipëri gjatë periudhës 2023–2025 tregojnë një zhvillim me luhatje të ndjeshme në numrin e viktimave me pasoja vdekje dhe ndryshime të ndjeshme në profilin demografik të autorëve. Në vitin 2023, janë regjistruar 39 viktima me pasoja vdekje, duke e bërë atë vitin me numrin më të lartë të vrasjeve fatale në këtë periudhë. Kjo shifër përfaqëson një ngarkesë për institucionet e rendit dhe sugjeron prani të lartë të dhunës ekstreme në shoqëri. Ndërkohë, në vitin 2024, numri i vrasjeve me pasoja vdekje u ul ndjeshëm në vetëm 12 raste, një rënie e madhe prej mbi 69% krahasuar me një vit më parë. Në vitin 2025, për katër muajt e parë, janë raportuar 12 viktima, që nëse ritmi do të vazhdojë, mund të çojë në një rritje të përqindjes vjetore, por gjithsesi brenda një niveli më të moderuar se ai i vitit 2023. Sa i përket autorëve të veprave penale të tipit vrasje, të dhënat tregojnë një zhvendosje graduale të



peshës kriminale nga grupmoshat më të reja drejt atyre më të moshuara. Në vitin 2023, grupmosha më e përfshirë ishte ajo 18–29 vjeç, me 16 autorë, ndjekur nga grupmosha 30–44 vjeç, me 15 autorë. Po ashtu, u regjistruan edhe 3 autorë të moshës 15–17 vjeç dhe kjo tregon një përfshirje të caktuar të adoleshentëve në veprimtari kriminale të rënda. Në vitin 2024, përfshirja e të rinjve nën 18 vjeç u rrit lehtë në 5 autorë, ndërsa grupmoshat e rritura shfaqën rritje të dukshme, 19 autorë të moshës 30–44 vjeç, 14 në grupmoshën 18–29 vjeç dhe rritje të qartë edhe në grupmoshat 45–59 vjeç 7 autorë dhe mbi 60 vjeç 9 autorë. Kjo shpërndarje sugjeron se vrasjet në vitin 2024 ishin kryesisht të lidhura me moshën më të madhe, ç'ka mund të jetë reflektim i konflikteve familjare, të pronave apo çështjeve të natyrës ekonomike dhe sociale të akumuluar me kohë. Në vitin 2025, të dhënat për katër muaj tregojnë një ulje të ndjeshme të numrit të autorëve, me vetëm 8 raste të regjistruara, nga të cilët asnjë nuk i përket grupmoshës 15–17 vjeç. Vetëm 1 autor është në grupmoshën 18–29 vjeç, ndërsa përfshirja më e madhe është në grupmoshën 30–44 vjeç me 3 raste, si dhe dy autorë në secilën nga grupmoshat 45–59 vjeç dhe mbi 60 vjeç. Kjo shpërndarje tregon një dominim të autorëve në moshë më të pjekur për vitin 2025, ndonëse përfundime të plota nuk mund të nxirren për shkak të mungesës së të dhënave vjetore të plota. Megjithatë, nëse ritmi aktual i ngjarjeve ruhet deri në fund të vitit, numri i vrasjeve me pasoja vdekje për vitin 2025 pritet të arrijë rreth 36 raste, një projektion i ndërtuar mbi bazën e të dhënave të periudhës Janar–Prill dhe që e vendos këtë vit thuhet në të njëjtin nivel me vitin 2023. Ky zhvillim ngre shqetësime për një rritje të mundshme të dhunës fatale në muajt në vijim, duke kërkuar vëmendje të shtuar institucionale. Në tërësi, viti 2023 përfaqëson kulmin e dhunës fatale për këtë periudhë, ndërsa 2024 dhe pjesërisht 2025 paraqesin një ulje të ndjeshme të rasteve, por me zhvendosje të përfshirjes kriminale drejt grupmoshave më të mëdha. Ky fakt ngre pyetje mbi natyrën e konflikteve që çojnë në vrasje dhe nevojën për ndërhyrje të përshtatura për grupmoshat më të rritura, krahas ndërhyrjeve të hershme të të rinjtë.



Tabela.3 Vrasje ndër vite (2023–2025)

Viti	Vrasje me pasoja vdekje	Autorë 15–17 vjeç	Autorë 18–29 vjeç	Autorë 30–44 vjeç	Autorë 45–59 vjeç	Autorë mbi 60 vjeç	Autorë gjithsej
2023	39	3	16	15	2	5	42
2024	12	5	14	19	7	9	55
2025	12	0	1	3	2	2	8

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. (2025, 13 qershor). Të dhëna statistikore për vrasjet, vetëvrasjet dhe rastet e dhunës për të rinjtë 2023–2025.

2.4 Analiza e rasteve të dhunës me dashje ndër vite (2023- 2025)

Dhuna me dashje përfaqëson një nga format më të përhapura të dhunës ndërpersonale dhe një tregues thelbësor për matjen e stabilitetit social dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë. Gjatë vitit 2023, në Shqipëri u raportuan gjithsej 940 raste të dhunës me dashje, sipas të dhënave të Policisë së Shtetit. Ky numër përfaqëson një nivel të lartë të dhunës në shoqëri dhe sugjeron një përhapje të konsiderueshme të konflikteve të zgjidhura përmes agresionit fizik në mjedise të ndryshme, përfshirë familjen, rugën, vendin e punës apo institucionet arsimore. Rëndësia e kësaj shifre shtohet edhe më shumë kur merret parasysh se shumë raste të dhunës së lehtë nuk raportohen kurrë, duke bërë që niveli real i dhunës të jetë ndoshta edhe më i lartë se ai i dokumentuar zyrtarisht. Në vitin 2024, numri i rasteve të dhunës me dashje u rrit në 1,023, duke shënuar një rritje prej 83 rastesh krahasuar me vitin e mëparshëm, ose rreth 8.8% më shumë. Kjo rritje është domethënëse dhe tregon se fenomeni i dhunës nuk është thjesht i qëndrueshëm, por ka prirje të dukshme në rritje. Shkalla e përshpejtimit të rasteve sugjeron se ndërhyrjet e deritanishme nuk kanë qenë të mjaftueshme për të frenuar përhapjen e dhunës dhe se faktorë si stresi ekonomik, tensionet familjare, mungesa e mekanizmave të zgjidhjes së konflikteve në mënyrë paqësore apo mungesa e ndërhyrjeve psikosociale po ndikojnë në përkeqësimin e situatës. Të dhënat për vitin 2025 janë të kufizuara vetëm për periudhën Janar–Prill dhe raportojnë 445 raste dhune me dashje. Megjithatë, edhe vetëm në bazë të kësaj periudhe të shkurtër, është e mundur të projektohet një numër vjetor që do të arrinte afërsisht në 1,335 raste deri në fund të vitit një rritje me rreth 30% në krahasim me vitin 2023 dhe mbi 30% edhe krahasuar me vitin 2024. Një përshkallëzim i tillë, nëse konfirmohet nga të dhënat për muajt pasues, do të përbënte një zhvillim alarmant dhe do të sinjalizonte një përkeqësim të ndjeshëm të klimës së sigurisë në vend. Ai gjithashtu do të vërtetonte se ndërhyrjet ekzistuese jo vetëm



që nuk kanë pasur efekte frenuese, por se fenomeni është jashtë kontrollit të strukturave aktuale të parandalimit. Duhet theksuar se dhuna me dashje nuk është një akt i izoluar, por shpesh rrjedh nga një sërë faktorësh të ndërlidhur si konflikte të përsëritura, mungesë kontrolli emocional, ndikim i konsumit të alkoolit apo substancave, si dhe nga mungesa e mekanizmave institucionalë për zgjidhjen e konflikteve në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë. Në këtë kontekst, rritja e dhunës me dashje nuk mund të trajtohet vetëm si një problem penal, por kërkon një zgjidhje të koordinuar që përfshin shërbimet sociale, institucionet arsimore, komunitetet vendore dhe median. Si përmbledhje, rastet e dhunës me dashje në Shqipëri po ndjekin një trajektore në rritje nga viti në vit, me një përshejtim të ndjeshëm të evidentuar në tremujorin e parë të vitit 2025. Nëse nuk merren masa të menjëhershme dhe gjithëpërfshirëse në drejtim të parandalimit të dhunës, edukimit për menaxhimin e emocioneve dhe ndërhyrjes së hershme në rastet problematike, ekziston rreziku që dhuna të normalizohet në jetën publike dhe familjare, duke dëmtuar jo vetëm sigurinë individuale, por edhe kohëzisionin shoqëror në tërësi.

Tabela.4 Raste të dhunës me dashje në Shqipëri, krahasim ndërvite 2023, 2024 dhe projeksion për 2025

Viti	Raste dhune me dashje	Ndryshimi nga viti paraardhës
2023	940	-
2024	1,023	+8.8%
2025	445 (Janar–Prill) Projeksioni 1,335	Projeksioni 1,335 +30.5% krahasuar me 2023

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit. (2025, 13 qershor). Të dhëna statistikore për vrasjet, vetëvrasjet dhe rastet e dhunës për të rinjtë 2023–2025.

2.5 Faktorët nxitës

Në mbarë botën, vetëvrasja është ndër shkaqet kryesore të vdekjeve tek të rinjtë, ku OBSH e cilëson si shkaku i tretë kryesor i vdekjes për moshat 15–29 vjeç, me mbi 720 mijë persona që humbin jetën çdo vit⁵. Këto fenomene kanë natyrë komplekse dhe shumëfaktorëshe, ku kontribuojnë elementë socialë, kulturorë, psikologjikë e mjedisorë⁵. Edhe në Shqipëri vihet re një trend shqetësues sipas INSTAT, rastet e vetëvrasjeve u rritën nga 81 në vitin 2022, në 98 në 2023 dhe 112 në 2024⁶. Psikologët vendas evidentojnë një sërë faktorësh të lidhur me këto rritje si vështirësitë ekonomike,

⁵ Suicide <https://www.who.int/news-room/fact-sheets/detail/suicide>

⁶ Numri i vetëvrasjeve në Shqipëri mbetet i lartë <https://www.zeramerikes.com/a/7981750.html>



stresi dhe ankthi, konfliktet familjare, çrregullimet e shëndetit mendor, abuzimi me alkoolin apo drogën, si edhe bullizmi dhe mungesa e mbështetjes sociale⁶. Shpesh aktet vetëvrasëse ndodhin në momente krize dhe impulsi, kur individi nuk përballon dot streset jetësore (p.sh. probleme financiare, konflikte në marrëdhënie). Një histori e ngjashme vërehet edhe tek dhuna me dashje midis të rinjve përjetimi i dhunës, abuzimit ose izolimit shoqëror që lidhet ngushtë me sjelljet agresive dhe vetëvrasëse⁵. Një rast ekstrem ishte ai në nëntor 2024, kur një 14-vjeçar u vra me thikë nga shoku i klasës pas një konflikti të nisur në rrjetet sociale⁷ ngjarje që ngriti alarmin për ndikimin e bullizmit online dhe përmbajtjeve të dëmshme të rinjtë. Studimet tregojnë se bullizmi përfshirë atë kibernetik mund të ketë pasoja serioze për shëndetin mendor të të rinjve. Një anketë globale e UNICEF-it gjeti se më shumë se një e treta e të rinjve kanë qenë viktimë të bullizmit në internet, faktor ky që kontribuon në rritjen e ankthit, depresionit dhe mendimeve vetëvrasëse tek ta. Me shqetësimin e shtuar rreth ndikimit të platformave digjitale, qeveria shqiptare mori masa drastike si mbyllja e TikTok për një vit (efektiv në 2025) duke fajësuar këtë rrjet për nxitjen e bullizmit dhe dhunës mes të rinjve⁸. Megjithatë, të dhënat tregojnë se kjo mbyllje nuk ka sjellë uljen e rasteve të dhunës apo vetëvrasjeve përkundrazi, incidentet kanë vazhduar të rriten gjatë periudhës 2023–2025, duke reflektuar se problemet bazë mbeten të pazgjidhura⁶. Kjo tregon se ndalimi i një platforme të vetme nuk është masë e mjaftueshme për adresimin e një dukurie kaq komplekse. Ekspertët ndërkombëtarë theksojnë nevojën për politika gjithëpërfshirëse që trajtojnë rrënjët e problemit dhe fuqizojnë faktorët mbrojtës. Organizata Botërore e Shëndetësisë nënvizon se parandalimi i vetëvrasjeve dhe dhunës kërkon një strategji të integruar dhe multisektoriale, meqenëse faktorët ndikues janë të larmishëm dhe të ndërlikur.⁵ Po ashtu, Save the Children argumenton se reagimet impulsive të tilla si kufizimi i aksesit digjital nuk i mbrojnë realisht fëmijët përkundrazi, ato mund t'i bëjnë të rinjtë më pak të prirur të kërkojnë ndihmë, ndërkohë që rreziket e vërteta (si bullizmi kibernetik, abuzimi apo shfrytëzimi online) mbeten të pranishme.⁹ Prandaj, qasja e duhur politike duhet të jetë e balancuar dhe gjithëpërfshirëse, duke kombinuar masat për sigurinë digjitale me investimet në shëndetin

⁷ Albania starts turning off TikTok amid concern over youth violence

<https://www.reuters.com/technology/albania-starts-turning-off-tiktok-amid-concern-over-youth-violence-2025-03-13/>

⁸ Albania to ban TikTok for one year, blaming it for inciting youth violence and bullying [Albania to ban TikTok for one year, blaming it for inciting youth violence and bullying | Euronews](#)

⁹ Why Children Need Protection in a Digital World <https://www.savethechildren.org/us/charity-stories/why-children-need-protection-in-a-digital-world>



mendor të të rinjve. Kjo nënkupton edukimin e tyre për përdorimin e sigurt të internetit, forcimin e shërbimeve të kujdesit mendor e psikosocial, programe anti-bullizëm në shkolla, si dhe mbështetje për familjet në krizë. Edhe në rajonin e Ballkanit po merren hapa në këtë drejtim në vitin 2023, Shqipëria iu bashkua një programi të përbashkët UNICEF-OBSH për të përmirësuar shërbimet e shëndetit mendor tek fëmijët e adoleshentët, me anë të bashkëpunimit ndërsektorial dhe forcimit të kujdesit komunitar¹⁰. Në përfundim, është e qartë se vetëm përmes një strategjie të integruar dhe të bazuar në prova e cila adreson njëkohësisht sigurinë digjitale dhe mirëqenien mendore mund të arrihet mbrojtja e të rinjve nga vetëvrasjet dhe dhuna, duke i trajtuar shkaqet e problemit në vend që thjesht të kufizohet një simptomë e tij.

3. ROLI I TIKTOK NË NXITJEN OSE PARANDALIMIN E DHUNËS

3.1 Gjetjet nga pyetësi: Ndikimi i rrjeteve sociale dhe mbyllja e TikTok-ut


Për të kuptuar më thellë perceptimet dhe përjetimet e të rinjve lidhur me mbylljen e TikTok dhe ndikimin e saj në nivelin e dhunës dhe mirëqenien emocionale, u realizua një pyetësor me 304 pjesëmarrës. Nga ky kampion, 80.6% ishin femra dhe 19.4% meshkuj, duke përfaqësuar një grup të gjerë të përdoruesve të rinj të rrjeteve sociale në Shqipëri. Në aspektin e moshës, pjesa dërmuese e të anketuarve i përkasin grupmoshës 18–24 vjeç (75.7%), ndjekur nga 14–17 vjeç (11.2%), 25–30 vjeç (6.6%), mbi 30 vjeç (4.6%), ndërsa 2% janë nën moshën 14 vjeç. Pyetjet e pyetësit u hartuan për të identifikuar nivelin e ekspozimit ndaj përmbajtjes së dhunshme në rrjete sociale, ndjeshmërinë ndaj ndikimeve emocionale dhe ndryshimet e përjetuara pas mbylljes së TikTok në Shqipëri. Në vijim paraqiten grafikisht të dhënat më të rëndësishme të pyetësit, të cilat ndihmojnë në ndërtimin e një narrative të bazuar mbi përvojat individuale të përdoruesve. Analiza e këtyre të dhënave shërben si plotësim i informacionit statistikor zyrtar dhe na mundëson të kuptojmë më qartë dimensionet psikologjike dhe sociale të kësaj ndërhyrje digjitale.



¹⁰ Child and adolescent mental health high on agenda in 3 countries in Europe
<https://www.who.int/europe/news/item/13-06-2023-child-and-adolescent-mental-health-high-on-agenda-in-3-countries-in-europe>

11. A e ke ndjerë ndonjëherë veten të ndikuar negativisht nga përmbajtja në rrjete sociale?


304 responses



Të dhënat tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve kanë përjetuar ndikim negativ nga përmbajtja në rrjete sociale. 12.5% deklarojnë se janë ndikuar shpesh, ndërsa 27% ndonjëherë dhe 25% rrallë. Kjo nënkupton se rreth 64.5% e të rinjve kanë pasur në një formë ose tjetër ndjesi negative të lidhura me përmbajtjen online. Vetëm 35.5% e të anketuarve raportojnë se nuk janë ndjerë ndonjëherë të ndikuar negativisht.

3. Cilin rrjet social përdorni më shpesh ?

304 responses




Rezultatet tregojnë një shpërndarje dominuese të përdorimit të rrjeteve sociale në favor të dy platformave: Instagram (51.6%) dhe TikTok (34.5%). Këto të dhëna konfirmojnë se të rinjtë shqiptarë janë kryesisht të përqendruar në rrjete që ofrojnë përmbajtje vizuale intensive, ndërveprim të menjëhershëm dhe akses të lehtë ndaj trendeve globale. Të dhënat tregojnë gjithashtu që këto platforma nuk janë vetëm burime argëtimi, por edhe hapësira ku formësohet identiteti social dhe ekspozimi ndaj përmbajtjes. Ato kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në vetëvlerësimin, ankthin social dhe sjelljet imituese të përdoruesve. Pjesa tjetër e rrjeteve sociale, si Facebook,



Snapchat, YouTube dhe WhatsApp, përbëjnë së bashku një përqindje relativisht të ulët të përdorimit (rreth 14%). Kjo sugjeron se për brezin e ri, këto platforma nuk janë më hapësira kryesore të ndërveprimit social dhe digjital, duke e përforcuar më tej rolin dominant të TikTok dhe Instagram në jetën e përditshme të të rinjve.

5.A e përdorni aktualisht TikTok-un ?
304 responses




Rezultatet e këtij grafiku tregojnë një ndarje të qartë mes përdoruesve aktivë, pasivë dhe atyre që kanë braktisur ose nuk e kanë përdorur kurrë TikTok-un. Konkretisht, 38.2% e të anketuarve deklarojnë se e përdorin TikTok-un rregullisht, ndërsa 27% e përdorin ndonjëherë, duke e çuar numrin total të përdoruesve aktualë në 65.2%. Nga ana tjetër, 21.1% thonë se nuk e përdorin më, ndërsa 13.8% nuk e kanë përdorur kurrë. Këto shifra janë të rëndësishme për të vlerësuar efektivitetin e mbylljes së TikTok në Shqipëri, sepse ato tregojnë se një pjesë e madhe e të rinjve vazhdojnë të kenë akses në platformë, pavarësisht mbylljes formale. Vetëm një përqindje relativisht e vogël ka ndërprerë përdorimin, ndërkohë që një numër i konsiderueshëm (rreth 2 në 3 të rinj) vijon ta përdorë në një formë ose tjetër. Për më tepër, pjesa që nuk e ka përdorur kurrë TikTok-un (13.8%) tregon se ndonëse kjo platformë është shumë trendi, ekziston gjithsesi një segment i rinisë që mbetet jashtë në raport me trendet digjitale. Kjo mund të shpjegohet me faktorë si mospëlqimi individual, ndjekja e rrjeteve të tjera, kufizimet familjare, apo mungesa e interesit për përmbajtje të këtij lloji. Nga pikëpamja e analizës së ndikimit, të dhënat përforcojnë idenë se mbyllja e TikTok nuk ka arritur të ndërpresë përdorimin e platformës, duke ngritur pyetje serioze mbi efektivitetin dhe zbatueshmërinë reale të kësaj mase. Ky është një tregues i rëndësishëm për të vlerësuar më tej se sa realisht mbyllja ka ndikuar në përmbajtjen, sjelljet dhe mirëqenien e përdoruesve të rinj.



7. Për çfarë e ke përdorur zakonisht TikTok-un?

304 responses




Të dhënat zbulojnë që natyra argëtuese dhe pasive e përmbajtjes në TikTok mbizotëron bindshëm në mënyrën se si të rinjtë e përdorin këtë platformë. Mbi 77% e të anketuarve e përdorin TikTok-un për të parë video argëtuese, duke treguar qartë se kjo platformë është burimi kryesor i zbavitjes dhe kalimit të kohës për shumicën e përdoruesve. Në vend të dytë, 25% deklarojnë se e përdorin për të ndjekur trende dhe sfida, një komponent kyç i TikTok-ut që shpesh lidhet me rrezikshmëri dhe ndikim social, sidomos te moshat e reja. Për më tepër, 17.8% ndjekin personazhe të famshëm, ndërsa 11.2% kanë postuar vetë video, duke treguar një përqindje më të vogël të përdoruesve aktivë që krijojnë kontent. Vetëm 6.3% e përdorin për të shprehur mendimet, ç'ka sugjeron se TikTok nuk konsiderohet si një hapësirë e sigurt për ndarë aspekte personale apo emocionale. Pjesa tjetër e alternativave të përmendura (si receta, informacion edukativ apo video informuese) përbëjnë një përqindje thuajse të papërfillshme, 0.3%, duke treguar se funksioni edukues ose informues i platformës është minimal në këtë kampion. Në përgjithësi, këto të dhëna konfirmojnë se TikTok përdoret më së shumti si një mjet zbavitje dhe ndjekje e trendeve, dhe më pak si një mjet për reflektim personal ose edukim. Kjo e bën platformën veçanërisht të ndjeshme ndaj përhapjes së përmbajtjes problematike, e cila përthithet me intensitet të lartë nga një audiencë e madhe që konsumon përmbajtje pa reflektuar ndikimin e saj.



8.A je ndeshur ndonjëherë me përmbajtje të dhunshme në TikTok?

304 responses




Ky grafik jep një pamje shqetësuese mbi shkallën e ekspozimit të të rinjve ndaj përmbajtjes së dhunshme në TikTok. Rreth 78.9% e të anketuarve (kombinimi i atyre që janë ndeshur shpesh, ndonjëherë ose rrallë) kanë hasur të paktën një herë përmbajtje të kësaj natyre në platformë. Po mbizotërojnë ato me 30.9% rrallë, 28.6% ndonjëherë dhe 19.4% që e kanë përjetuar shpesh. Vetëm 7.2% raportojnë se nuk janë ndeshur kurrë, ndërsa 13.8% të tjerë nuk e kanë përdorur TikTok-un, duke përforcuar përfundimin se një përqindje e konsiderueshme e përdoruesve aktivë ka qenë e ekspozuar ndaj përmbajtjes me karakter dhune ndonëse “rrallë”. Ky rezultat është i rëndësishëm sepse tregon një përhapje sistematike të përmbajtjes së dhunshme në platformë, e cila, edhe nëse nuk synohet drejtpërdrejt nga përdoruesit, por shfaqet në mënyrë të përsëritur gjatë scrolling. Për më tepër, fakti që një përqindje e konsiderueshme e të rinjve raportojnë ekspozim të rregullt ose të herëpashershëm sugjeron një mungesë efektive të filtrave dhe kontrollit të përmbajtjes nga algoritmet e TikTok, sidomos në vende më pak të strike si Shqipëria. Ky është një sinjal i qartë për domosdoshmërinë e vendosjes së filtrave dhe elementeve të sigurisë në nivel platforme, ashtu siç aplikohet tashmë në rrjete të tjera si META (Facebook dhe Instagram).



9. Çfarë lloj përmbytjesh dhune ke hasur më shpesh në TikTok? (Mund të zgjidhni disa)

304 responses




Grafiku tregon se forma më e zakonshme e përmbytjes së dhunshme në TikTok është bullizmi dhe fyerjet verbale, të raportuara nga 68.8% e pjesëmarrësve. Kjo pasohet nga përmbytje urrejtje si racizëm, homofobi, seksizëm (54.3%) dhe dhuna fizike reale (21.4%). Gjithashtu, 13.2% e të anketuarve raportojnë se janë hasur me përmbytje që nxit vetëdëmtimin ose vetëvrasjen, një gjetje shqetësuese që lidhet drejtpërdrejt me shëndetin mendor. Dhuna gjinore ndaj grave (19.1%) është gjithashtu e përhapur. Këto të dhëna tregojnë qartë se TikTok përmban forma të shumëllojshme dhune, ku dominon dhuna psikologjike, por nuk mungojnë as format më eksplicite dhe të rrezikshme për mirëqenien e përdoruesve. Kjo mbështet domosdoshmërinë për masa mbrojtëse dhe edukim mediatik, sidomos për grupmoshat më të ndjeshme.



12. Si ka ndikuar mbyllja e TikTok-ut tek ti ?

304 responses




- Jam ndier më i qetë
- Kam kaluar më shumë kohë në platfor...
- Kam pasur më pak kontakte sociale
- Nuk ka ndryshuar asgjë për mua
- Nuk kam përdorur kurrë tik tok
- Rrjete sociale jane te gjitha dhe ne mo...
- Kam instaluar VPN
- Kam VPN

▲ 1/3 ▼

Të dhënat tregojnë se për më shumë se gjysmën e të anketuarve (52.6%), mbyllja e TikTok nuk solli asnjë ndryshim në përditshmërinë apo gjendjen e tyre. Nga ana tjetër, një përqindje jo e vogël ka raportuar ndikime emocionale ose sociale, 24% thonë se kanë kaluar më shumë kohë në platforma të tjera, gjë që tregon zhvendosje të aktivitetit online, jo reduktim. 12.5% thonë se janë ndier më të qetë, pra ka pasur një efekt pozitiv. Një tjetër 5.3% raportojnë se kanë pasur më pak kontakte sociale, ç'ka mund të tregojë ndjesi izolimi apo mungesë ndërveprimi, veçanërisht nëse TikTok ka qenë për ta burim i komunikimit. Pjesa tjetër, me përqindje shumë të vogla, përmend përdorimin e VPN, ose deklarojnë se nuk e kanë përdorur kurrë TikTok-un. Në përgjithësi, këto të dhëna sugjerojnë se ndalimi nuk pati një efekt uniform, pasi efekti politikës së mbylljes është i vogël sepse po përdoret me VPN.

13. Sipas mendimit tënd, a ka ndikuar mbyllja e TikTok në nivelin e dhunës tek të rinjtë?

304 responses



- Po, e ka ulur dhunën
- Jo, nuk ka pasur ndikim
- E ka përkeqësuar situatën
- Nuk e di


Grafiku tregon se shumica e të rinjve nuk e perceptojnë mbylljen e TikTok si një masë efektive për reduktimin e dhunës. 59.2% e të anketuarve mendojnë se mbyllja nuk ka pasur ndikim, ndërsa vetëm 10.9% besojnë se ka ndikuar pozitivisht në uljen e dhunës. Ndërkohë, një pjesë më e vogël (6.3%) shprehen se mbyllja e ka përkeqësuar



situatën dhe 23.7% nuk kanë një mendim të qartë mbi situatën. Këto të dhëna theksojnë një mospërputhje midis ndërhyrjeve institucionale dhe perceptimit real të të rinjve për efektivitetin e tyre. Nëse shumica nuk e perceptojnë mbylljen si një masë që ka ulur dhunën, atëherë kjo nxit nevojën për të rishikuar politikat dhe për t'i zëvendësuar me qasje më të ndërgjegjshme, edukative dhe gjithëpërfshirëse.

16. Si ka qenë gjendja jote emocionale gjatë 6 muajve të fundit?

304 responses




Ky grafik plotëson tablonë e rëndësisë mbi mirëqenien emocionale të të rinjve. Rreth 63.2% e të anketuarve raportojnë se kanë pasur gjendje pozitive apo të qëndrueshme, 28% e përshkruajnë veten si me gjendje shumë të mirë dhe 35.2% si kryesisht të qëndrueshme. Megjithatë, një përqindje jo e vogël e të rinjve përjetojnë vështirësi emocionale, 17.4% e përshkruajnë gjendjen si të luhatshme dhe 8.9% raportojnë ndjenja të shpeshta ankthi, stresi apo trishtimi. Ky është një tregues i qartë se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve ndodhen në një zonë të ndjeshme emocionale, që kërkon vëmendje të shtuar nga institucionet dhe profesionistët e shëndetit mendor. Gjithashtu, 10.5% nuk kanë preferuar të japin një përgjigje, ç'ka mund të sugjerojë ose pasiguri, ose mungesë besimi për të ndarë përvojat emocionale në një kontekst anonim pyetësori.



17. Cilat prej situatave më poshtë ndikon më shumë tek gjendja jote emocionale? (Mund të zgjedhësh disa)

304 responses




Të dhënat na ndihmojnë të kuptojmë burimet kryesore të presionit emocional të të rinjtë dhe nga përgjigjja e pjesëmarrësve, stresi shkollor dhe akademik është faktori dominues, 72.4% e tyre e përmendin si ndikuesin kryesor të gjendjes së tyre emocionale. Kjo nxjerr në pah ngarkesën e madhe që lidhet me performancën dhe pritshmëritë. Në vend të dytë renditen problemet në familje (35.9%), të cilat shpesh përbëjnë një burim të rëndësishëm pasigurie dhe destabiliteti emocional për të rinjtë. Po ashtu, vetmia, izolimi social (18.4%) dhe vështirësitë ekonomike (25%) janë faktorë që kontribuojnë dukshëm në ndjenjat e ankthit apo trishtimit. Megjithatë përqindje më të ulët, ndikimi rezultuan nga rrjetet sociale (9.5%) dhe bullizmi/mospranimi nga të tjerët (6.9%) nuk janë të papërfillshme. Ato përfaqësojnë ndikimin indirekt që platformat digjitale dhe ndërveprimi online mund të kenë në vetëbesimin dhe mirëqenien emocionale të të rinjve. Në këtë grafik bie në sy gjithashtu prania e një sërë përgjigjesh të shpërndara dhe individuale (p.sh., presioni për të ardhmen, problemet personale ose madje edhe humori), që sugjerojnë një variacion përvojash emocionale, por që shpesh nuk janë adresuar institucionalisht.



18. Si e vlerëson punën e institucioneve shtetërore në parandalimin e dhunës tek të rinjtë?


304 responses



Të dhënat e këtij grafiku reflektojnë një perceptim kryesisht negativ ose mosbesues ndaj rolit të institucioneve shtetërore në parandalimin e dhunës. Konkretisht 35.9% e të rinjve i konsiderojnë institucionet jo efektive në këtë fushë, ndërsa 26.6% i vlerësojnë si pak efektive. Pra, mbi 62% e të rinjve mendojnë se institucionet nuk po arrijnë të ofrojnë një mbështetje të ndjeshme ose të dukshme në parandalimin e dhunës. Vetëm një përqindje shumë e vogël i konsideron institucionet shumë efektive (7.2%) apo disi efektive (21.7%), ndërkohë që 8.6% deklarojnë se nuk kanë informacion, ç'ka tregon edhe mungesë transparence, komunikimi institucional apo përfshirje në fushata ndërgjegjësimi. Ky nivel i lartë skepticizmi është tregues i një ndarje midis politikave publike dhe perceptimit real të rinisë, që duhet marrë parasysh në hartimin e strategjive të ardhshme, jo vetëm që ndërhyrjet duhet të jenë më efektive, por edhe më të dukshme, transparente dhe të përfshijnë drejtpërdrejt të rinjtë si aktorë të ndryshimit.

19. A keni dijeni nëse ka një paketë për sigurinë në shkollë ?

304 responses



Grafiku tregon një mungesë të dukshme informacioni mes të rinjve në lidhje me masat institucionale për sigurinë në shkollë. Vetëm 29.9% e pjesëmarrësve kanë dijeni për ekzistencën e një pakete të tillë, ndërsa 70.1% nuk janë në dijeni. Kjo shifër është shqetësuese duke pasur parasysh se siguria në shkollë është një çështje thelbësore për mirëqenien fizike dhe emocionale të të rinjve dhe



çdo politikë apo paketë ndërhyrëse që nuk është e njohur nga grupi i synuar, rrezikon të jetë joefektive në praktikë.

3.2 A ndikoi mbyllja e TikTok në uljen e dhunës dhe përmirësimin e shëndetit mendor?

Vendimi për të mbyllur përkohësisht TikTok-un në Shqipëri u prezantua si një përpjekje për të mbrojtur të rinjtë nga përmbajtje e dëmshme dhe për të parandaluar pasojat e rënda që lidhen me dhunën digjitale. Por, një analizë krahasuese e të dhënave statistikore nga Policia e Shtetit me perceptimet e 304 të rinjve që morën pjesë në pyetësor të hartuar për këtë qëllim, sugjeron se ky veprim nuk ka prodhuar efektin e pritshëm. Përkundrazi, të dhënat flasin për një përkeqësim të disa treguesve kyç. Së pari, rastet e vetëvrasjeve kanë ndjekur një trend rritës gjatë periudhës 2023–2025. Në vitin 2023 janë regjistruar 98 vetëvrasje, për t'u rritur në 112 në vitin 2024 një rritje prej 14.3%. Por më shqetësuese është situata në vitin 2025, ku vetëm për periudhën Janar-Prill janë regjistruar 45 raste. Nëse kjo tendencë vazhdon, numri total mund të arrijë rreth 135 raste deri në fund të vitit një rritje prej mbi 37% krahasuar me vitin 2023. Nëse mbyllja e TikTok ishte menduar si një instrument për të frenuar ndjenjat e izolimit dhe sjelljet vetëdëmtuese, këto të dhëna sugjerojnë se masa nuk ka qenë efektive. Për më tepër, nga pyetësi rezultoi se 13.2% e të rinjve janë ekspozuar ndaj përmbajtjes që nxit vetëdëmtimin ose vetëvrasjen në TikTok, ndërsa 64.5% e të anketuarve pranojnë se janë ndikuar negativisht nga përmbajtja në rrjetet sociale një dëshmi se problemi nuk ndalet me mbylljen një platforme të vetme. Së dyti, numri i tentativave për vetëvrasje qëndroi konstant në 79 raste gjatë vitit 2024, ndërsa në katërmujorin e parë të 2025 janë raportuar 28 raste, me projeksion rreth 84 në fund të vitit një rritje modeste, por e vazhdueshme. Kjo përforcon faktin se ndalimi i TikTok nuk ka ndikuar as në uljen e rasteve të tentativave për vetëdëmtim. Një nga arsyt mund të qëndrojë në faktin se ndalimi nuk shoqërohet me ofrim alternativash, si mbështetje psikologjike, edukim mediatik, apo hapësira për angazhim të shëndetshëm social. Së treti, një ndër treguesit më alarmantë është rritja e dhunës me dashje. Nga 940 raste në 2023, kjo shifër u rrit në 1,023 në 2024 dhe në vetëm katër muaj të vitit 2025 janë regjistruar 445 raste, me një projeksion vjetor rreth 1,335 raste një rritje drastike me mbi 41% krahasuar me vitin 2023. Në pyetësor, 78.9% e të rinjve raportojnë se kanë qenë të ekspozuar ndaj përmbajtjes së dhunshme në TikTok, ndërsa 68.8% identifikojnë



bullizmin dhe fyerjet si përmbajtjen më të zakonshme. Megjithatë, mbyllja e platformës nuk e ka ndalur këtë ekspozim 56.6% e të rinjve deklarojnë se e përdorin ende TikTok-un, përmes VPN apo mënyrave të tjera, duke treguar se ndërhyrja institucionale nuk ka qenë as funksionale, as e qëndrueshme. Në lidhje me vrasjet me pasoja vdekje, edhe pse ato ranë nga 39 raste në 2023 në 12 raste në 2024, viti 2025 ka shënuar sërish 12 vrasje vetëm në katër muajt e parë. Nëse kjo prirje vijon, numri mund të arrijë 36 në fund të vitit, duke u kthyer në nivelet e vitit 2023. Kjo sugjeron se ulja e përkohshme nuk lidhet domosdoshmërisht me ndalimin e TikTok, por ndoshta me faktorë të tjerë momentalë. Së fundmi, vetëm 12.5% e të rinjve mendojnë se mbyllja e TikTok ka ndikuar pozitivisht në uljen e dhunës, ndërsa 76.6% mendojnë se nuk ka pasur asnjë efekt. Kjo mospërputhje midis objektivit të politikës dhe perceptimit të grupit që ajo synon të mbrojë, është një indikator serioz i dështimit të ndërhyrjes. Për më tepër, më shumë se gjysma e të rinjve (52.6%) raportojnë se nuk përjetuan asnjë ndryshim në mirëqenien e tyre pas mbylljes së TikTok. Në lidhje me mirëqenien emocionale, gjetjet përforcojnë nevojën për qasje të integruara dhe të ndjeshme ndaj shëndetit mendor për më shumë se 17.4% e të rinjve gjendja është e luhatshme ose me prirje negative, ndërsa faktori kryesor i stresit emocional mbetet presioni shkollor (72.4%), i ndjekur nga problemet familjare (35.9%) dhe vështirësitë ekonomike (25%). Ndikimi i rrjeteve sociale përmendet nga 9.5% si një faktor destabilizues emocional. Kjo tregon se, ndonëse TikTok ka ndikim, ai nuk është burimi i vetëm i stresit, por funksionon si një nxitës i një gjendje tashmë të brishtë. Së fundmi, perceptimi ndaj institucioneve shtetërore është kryesisht negativ ose neutral. Rreth 62% e të rinjve i konsiderojnë institucionet si jo efektive në parandalimin e dhunës, ndërsa 70.1% nuk janë fare të informuar për ekzistencën e një pakete sigurie në shkolla. Kjo tregon për një mungesë të thellë transparence dhe komunikimi institucional, që përkeqëson ndjesinë e pasigurisë dhe distancës midis politikëbërjes dhe realitetit të jetës së të rinjve. Në përmbledhje, të dhënat tregojnë se mbyllja e TikTok nuk arriti të ndalojë apo të frenojë fenomenet që pretendonte të adresonte. Dhuna, vetëvrasjet dhe gjendja psikologjike e të rinjve kanë ndjekur një trajektore përkeqësimi pavarësisht kësaj mase. Ky realitet vë në pah nevojën urgjente për politika publike të bazuara në evidenca, me fokus në ndërhyrje strukturore, edukim mediatik, mbështetje psikologjike dhe përfshirje të vetë të rinjve në krijimin e zgjidhjeve.



GJETJET KRYESORE

- Mbyllja e përkohshme e TikTok nuk solli efekt në uljen e dhunës apo përmirësimin e shëndetit mendor të të rinjve. Të dhënat zyrtare tregojnë se vetëvrasjet u rritën nga 98 në vitin 2023 në 112 në vitin 2024 dhe për katërmujorin e parë të vitit 2025 janë regjistruar tashmë 45 raste, duke projektuar një numër edhe më alarmant deri në fund të vitit prej 135. Po ashtu, rastet e dhunës me dashje janë shtuar nga 940 në vitin 2023 në një projeksion prej 1,335 për vitin 2025.
- Prania e më shumë se 230 tentativave për vetëvrasje në vetëm 28 muaj (Janar 2023–Prill 2025) është një tregues i pamohueshëm i rëndësës që ka kriza e shëndetit mendor në vend dhe i urgjencës për të ndërhyrë në mënyrë gjithëpërfshirëse në parandalimin dhe trajtimin e saj.
- Përdorimi i TikTok vazhdoi edhe gjatë periudhës së mbylljes. 56.6% e të rinjve të anketuar e kanë përdorur platformën, duke e bërë të qartë se masa administrative nuk arriti të ndalojë realisht aksesin në TikTok, për shkak të përdorimit të gjerë të VPN-ve dhe mungesës së mekanizmave mbikëqyrës efektivë.
- Perceptimi i të rinjve ndaj masave shtetërore dhe institucioneve është negativ. Rreth 62% e tyre i konsiderojnë institucionet jo efektive ose pak efektive në parandalimin e dhunës, ndërsa mbi 70.1% nuk kanë dijeni për ekzistencën e një pakete sigurie në shkollë, duke treguar mungesë transparence dhe komunikimi institucional.



REKOMANDIME

- Nënshkrimi i një marrëveshjeje bashkëpunimi me TikTok për vendosjen e filtrave të përmbajtjes. Bazuar në faktin se 78.9% e të rinjve janë ndeshur me përmbajtje dhune në TikTok dhe se mbyllja e përkohshme nuk pati efekt, rekomandohet që institucionet shqiptare të nisin një bashkëpunim të drejtpërdrejtë me TikTok (siç është bërë tashmë në disa vende europiane), për vendosjen e algoritmeve që zbulojnë dhe bllokojnë automatikisht përmbajtje me bullizëm, vetëdëmtim, urrejtje ose dhunë. Ky hap nuk kërkon mbyllje të platformës, por siguron kontroll efektiv mbi rrezikun.
- Zëvendësimi i politikave ndëshkuese me ndërhyrje të bazuara në evidencë dhe edukim digjital në shkolla. Mbyllja e platformave nuk ndalon përdorimin e tyre (siç tregoi përdorimi masiv përmes VPN-ve). Prandaj, politika publike duhet të kalojë nga ndalimi në edukim të përdoruesit. Sugjerohet përfshirja e edukimit digjital në kurrikulën e shkollës, ku të mësohet identifikimi i përmbajtjes së dëmshme, menaxhimi i stresit dhe ndërtimi i marrëdhënieve të shëndetshme online.
- Përfshirja e të rinjve në dizajnimin dhe zbatimin e politikave që i prekin. Më shumë se 62% e të rinjve nuk i konsiderojnë institucionet si efektive në parandalimin e dhunës. Kjo ndodh sepse zëri i tyre mungon. Funksionimi i këshillave rinorë për bashkëhartimin e politikave, brenda bashkive dhe institucioneve, do të rriste besimin dhe do të sigurojë që masat e ndërmarra të jenë në përputhje me realitetin e përditshëm të të rinjve.
- Zbatimi rigoroz i legjislacionit mbi mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në mediat sociale. Shqipëria ka ligje për mbrojtjen e fëmijëve, por ato aplikohen rrallë në hapësirën digjitale. Kërkohej që Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe institucionet e tjera përkatëse të përgatisin udhëzime teknike të reja për rregullimin e përmbajtjes online, në përputhje me moshën, me mekanizma të ankimit dhe raportimit të lehtë për përdoruesit.



- Rritja e investimeve në shërbimet psikosociale për të rinjtë dhe forcimi i kapaciteteve profesionale në institucionet arsimore. Përballë një realiteti alarmues, ku janë regjistruar mbi 230 tentativa për vetëvrasje gjatë periudhës Janar 2023–Prill 2025, bëhet e domosdoshme ndërmarrja e masave të menjëhershme dhe afatgjata në drejtim të përmirësimit të mbështetjes së shëndetit mendor, veçanërisht për të rinjtë. Një prej problematikave më të theksuara në kontekstin shqiptar është mungesa serioze e mbulimit psikologjik në institucionet arsimore, ku raporti aktual shpesh tejkalon 1 psikolog për 1000 nxënës, ndonëse standardet ndërkombëtare rekomandojnë një raport 1:500 (American Psychological Association). Në këtë kuadër, rekomandohet zhvillimi i një *Programi Kombëtar të Shërbimeve Psikologjike për të Rinj*, i cili të ofrojë akses universal, pa pagesë dhe konfidencial në mbështetje psiko-emocionale. Ky program duhet të shtrihet në, të gjitha institucionet e arsimit parauniversitar dhe universitar, qendrat rinore komunitare dhe institucionet lokale të kujdesit social, struktura emergjente me linjë ndihme 24/7 për trajtimin e problemeve që lidhen me shëndetin mendor. Po ashtu, kërkohet rritja e numrit të psikologëve të punësuar, rishikimi i politikave të rekrutimit dhe shpërblimit, si dhe forcimi i kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve të vazhdueshme dhe mbikëqyrjes klinike. Këto masa përfaqësojnë një ndërhyrje strukturore që, nëse zbatohet në mënyrë të koordinuar, mund të ndikojë ndjeshëm në reduktimin e rasteve të vetëdëmtimit dhe përmirësimin e mirëqenies emocionale të të rinjve në Shqipëri.
- Është e nevojshme që MAS të krijojë një mekanizëm vlerësimi të vazhdueshëm të masave të sigurisë në shkolla, me indikatorë të qartë për efektivitetin e tyre, përfshirë anketime periodike të nxënësve, mësuesve dhe prindërve. Përdorimi i teknologjisë duhet të shoqërohet me trajnime për stafin pedagogjik dhe oficerët e sigurisë, që të kuptojnë psikodinamikën e sjelljes së nxënësve dhe të ndërhyjnë në kohë.



#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDORSEMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al